

Driton Dovolani

Biografia



Driton (Toni) Dovolani është njëri nga koreografët më të njohur në botë për vallëzim klasik. Dy vjet radhazi e ka zënë vendin e parë në botë. Tash nëntë stinorë shfaqet rregullisht në emisionin “Dancing with the stars” (Vallëzimi me yje), që është më i shikuari në Amerikë.

Në filmin “Shall we Dance”, Toni ka qenë koreograf personal i aktorëve Riçard Gir dhe Xhenifer Lopez. Prej dy dekadash jeton në Amerikë, por gjithmonë në zemrën e tij qëndron atdhedashuria për vendlindjen.

Driton Dovolani lindi në vitin 1973, në Prishtinë. Babai i tij ishte me prejardhje nga Dibra e Madhe, ndërsa nëna nga Kosova. Djaloshi, i cili po shkëlqen në skenat botërore për vallëzim klasik, hapat e parë i ka filluar në moshën trevjeçare në Prishtinë. “Kur isha tre vjeç, u mora me vallëzim folklorik, pastaj vallëzim klasik, ‘break dance’ e lloje të tjera, që atë kohë ishin në trend. Kur shkova në Amerikë, isha 15-vjeçar. Vitin e parë punova për ta mbajtur familjen, ndërsa në moshën 16-vjeçare u regjistrova në shkollën e vallëzimit “Fred Astaire Dance Academy”, të cilën e përfundova me sukses. Në vitin 2005, e zura vendin e parë në kampionatin botëror të vallëzimit, ndërsa në vitin 2006 e mbrojta këtë vend. Dy vjet radhazi jam shpallur kampion i botës për vallëzim. Tani jam anëtar i jurisë i kësaj gare botërore”, shtoi ai. Sukseset e tij nuk kanë fund. Toni merr pjesë në filmin “Shall we Dance”, në të cilin ka qenë koreograf personal i aktorëve të njohur botërorë – Riçard Gir dhe Xhenifer Lopez.

Për nëntë muaj, aktorët e Hollivudit kanë qenë nën “diktaturën” e koreografit kosovar. Toni tregon përvojën e tij me yjet e famshme. “Në fillim kisha pak drojë, por pas 2-3 orësh u bëmë të barabartë. E vendosa kapelën e mësuesit dhe ata me shumë respekt u përmbaheshin rregullave të

mia. Riçard Giri është shumë i afërt. Ai është mik imi i ngushtë, njohës i mirë i çështjes së Kosovës dhe njeriu i parë që ma ka uruar Pavarësinë. Po ashtu, edhe Xhenifer Lopezi është e mirë, punon shumë dhe është shumë profesioniste në punën që e bën”, shtoi mjeshtri i vallëzimit modern.

Pas njëzet vjetësh, verën e vitit të kaluar, Driton Tovolani e vizitoi për herë të parë Kosovën. Nuk kishte dashur që kjo vizitë të bëhej e zhurmshme, sepse dëshira e tij ishte t’i vizitonte të gjitha vendet në Kosovë dhe të çmallej me njerëzit, me të cilët e kishte kaluar fëmijërinë.

Por, ai shkoi edhe për së dyti në Kosovë... “Kam shumë kujtime të bukura nga Kosova. Kam shumë të afërm të familjes sime. Kur e vizitova Kosovën, m’u kënaq shpirti. A ka kënaqësi më të madhe që në kufi të thotë kufitari: “Mirë se erdhe në vendin tënd!”. Kjo ka qenë ëndrra e popullit shqiptar dhe jam i lumtur që edhe këtë ëndërr e realizuam”, ka thënë Toni gjatë vizitës së tij të dytë në Kosovë.

Toni prej vitesh është aktiv në serialin “Vallëzim me yje”, i cili xhirohet në Hollivud, ndërsa vazhdon të jetë më i shikuari në Amerikë. Në këtë serial, Toni shpeshherë ka treguar identitetin e tij kosovar, ku është paraqitur edhe me veshje kombëtare, me shqiponjë. “Në çdo sezon shfaqem në ndonjë vallëzim me veshje kombëtare. Para se të shfaqesha me këto veshje në serial, regjisorët nuk dëshironin të më lejonin, por kur ua shpjegova se sa e rëndësishme është për popullin tim që të paraqitem me këtë veshje, thanë: “Bëj çfarë të duash”. Valltari kosovar është i martuar me një princeshë,- siç thotë,- nga Dibra, me emrin Trëndelina. I ka tre fëmijë: vajza e madhe Luana dhe binjakët – Adriani dhe Arjana.